



## DEMOCRACYPLUS

### Konkurs Për Praktikantë

Democracy Plus kërkon dy (2) praktikantë për programin e praktikës. Praktikantët do të përfshihen në njërin nga programet e D+ në projekte të ndryshme.

**Programi i praktikës** zgjat 3 muaj (me gjysmë orari) dhe përfshin:

Asistencë në hulumtime për projekte të ndryshme, organizim të tryezave dhe konferencave, mbajtje të shënimeve në takime dhe ngjarje të ndërlidhura me punën e organizatës, përpilim të raporteve, përditësim të databazave të të dhënave, monitorim të medieve dhe punë të ndryshme në zyrë.

**Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:**

1. I/e diplomuar apo në vitin e fundit të studimeve në Shkenca Politike, Administratë/Politika Publike, Filozofi, Sociologji, apo Juridik;
2. Njohje e mirë e gjuhës angleze (përfshirë shkrimin);
3. Njohje e mirë punës me Microsoft Word dhe Excel, njohja e programeve tjera p.sh SPSS konsiderohet përparësi;
4. Aftësi të larta komunikimi verbal dhe me shkrim.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. CV dhe;
2. Cover letter/Letër motivimi në gjuhën angleze.

**Të interesuarit mund t'i dërgojnë aplikacionet në e-mail adresën: [info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org).**

**Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 31.05.2017.** Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen për intervistë. Ata që nuk kontaktohen deri në datën 05.06.2017 konsiderohen të refuzuar.

Puna praktike do të mbahet në zyrat e Democracy Plus në Prishtinë, adresa: Rruga Rexhep Luci, hyrja nr. 30, kati I, nga ora 9:00 – 13:00 apo nga ora 13:00 – 17:00.